




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS – SHTIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-16200/23 datë: 30.06.2023



Npi – 01/291 datë: 04.07.2023

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019. Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 04.07.2023, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -VII- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE

E mbajtur më: 04.07.2023 (e martë) në ora 14:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi, z.Bajram Ilazi, anëtarët e Komitetit për Komunitete: z.Besnik Seferi, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Mehmeti, z.Arton Demiri, znj.Shkurte Mustafa, dhe znj.Shkurte Behluli. Në mbledhje përveç anëtarëve të Komitetit kanë marrë pjesë edhe: z,Xhavit Fejza, dhe Sreçko Bogajçević, nga UNMIK-u, Praktikantet znj.Valmira Hoxha dhe znj.Sadbere Halili. Mbledhjen e hapi Kryesuesi z.Bajram Ilazi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Informatë nga DKA për përfundimin e vitit shkollor dhe regjistrimi i nxënësve,
2. Diskutime lidhur me punën e KPK në gjashtëmuajorin e parë Janar-Qershor,
3. Të ndryshme.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Besnik Seferi; Përshëndetje, pajtohem me rendin e ditës, jemi në prag të pushimeve verore, kështu që rendi i ditës është i pranueshëm.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Informatë nga DKA për përfundimin e vitit shkollor dhe regjistrimi i nxënësve

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Nuk e kemi drejtoreshën prezent për të na informuar.

z.Muhamet Mehmeti; Përshëndetje, disa informata që i kemi ne, del se janë të rexhistruar 6 nxënës nga Komuniteti pakicë, 3 parashkollor dhe 3 në klasën e parë në shkollën fillore në Shtime, ndërsa nuk kemi informata për fshatrat tjera të komunës së Shtimes për vitin 2023.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Ekziston Ligji për edukimin e hershëm. Fatkeqësisht nuk po kemi informata nga DKA-ja. Është mirë që DKA-ja me planifikuar ndonjë fushatë, për sa i përket rexhistrimit të fëmijve në shkollë, në parashkollor dhe në klasën e parë, mendoj se është mirë që ta bëj me kohë, sepse po rexhistrohen pastaj në muajin Shtator, e që konsideroj se nuk është mirë. Propozoj që ta bëjmë një Rekomandim për DKA-në, me qëllim për ta organizuar një fushatë të tillë sidomos në vendbanimet me komunitet pakicë, e që fushatën ta bëjnë së bashku me organizatat jo qeveritare vendore dhe ndërkombëtare.

* Komiteti për Komunitete, në mbledhjen e mbajtur me 04.07.2023, unanimisht vendosi t'i rekomandojë DKA-së, që së bashku me organizatat joqeveritare (OJQ) të organizojë fushatë për regjistrimin e fëmijëve në institucionet parashkollore dhe ato fillore të gjitha komuniteteve, por në veçanti të komunitetit pakicë.

Pika 2

Diskutime lidhur me punën e KPK në gjashtëmujorin e parë Janar-Qershor

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Ne sot po e diskutojmë raportin për punën 6 mujore të Komitetit për Komunitete, për mbledhjet që kemi mbajtur, si dhe për rekomandimet që i kemi miratuar. E falënderojmë zoteri Idajet Rexhepin, bashkëpunëtorin e Kuvendit që na ka përgatitur një raport të tillë të shkruar ku shihet qartë puna e jonë si Komitet për 6 mujorin e parë të 2023.

z.Besnik Seferi; Pa përgjegjësia e drejtorëve për pjesmarrje në mbledhjet e Komitetit po e zbehë edhe rëndësinë e këtijë Komiteti për Komunitete. Kjo pra është një vërejtje për drejtorët e drejtorive përkatëse që kanë qenë të ftuar dhe është dashur të marrin pjesë. Nuk e di se deri ku do të shkojnë. Ne edhe përkundër informatave të pakta për shkak të mos pjesmarrjes së disa drejtorëve në mbledhje, kemi punuar dhe kemi nxjerrë rekomandime mjaftë shumë. Unë të përgëzojë për punën Kryesues por edhe anëtarët e komitetit.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Unë ju falënderoj edhe juve anëtarëve të Komitetit që jeni anëtarë të Kuvendit dhe po i përcillni rekomandimet në Kuvend.

z.Arton Demiri; Ju falënderoj të gjithë anëtarëve të Komitetit për punën e bërë.


Pika 3

Të ndryshme

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë. Meqenëse diskutime nuk ka unë ju falënderoj për punën dhe bashkëpunimin, dhe ju dëshiroj pushime të mira këtë vit, po ashtu e falënderoj edhe sekretarinë e Kuvendit për punën e bërë dhe ju uroj pushime sa më të mira.

Meqenëse diskutime tjera nuk kishte mbledhjen Kryesuesi e përfundoi në ora 14:31h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit
Bajram Ilazi

